


# Bibël për fëmijët paraqet

## Samaritani i Mirë



Shkruar nga: Edward Hughes  
Ilustruar nga: M. Maillot; Lazarus

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi  
Adaptuar nga: Ruth Klassen; Sarah S.

Tregimi 46 nga 60


[www.M1914.org](http://www.M1914.org)

*Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada*

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.

Shqip

Albanian



"Duaj Perëndinë dhe të afërmin tënd", tha burri. "Por, kush është i afërmi im"?



3


Për t'ju përgjigjur pyetjes, Jezusi tregoi një histori, për një njeri që po udhëtonte nga Jerusalemi në Jeriko. Ky njeri u sulmua nga hajdutët.



4

Hajdutët i vodhën gjithçka, madje i morën edhe rrobat udhëtarit të shkretë. Ata e palgosën shumë keq, duke e lënë gjysëm të

vdekur anës rrugës.



5

5

Tani, ndodhi që një prift kaloi aty pranë. Me siguri ai do ta ndihmojë njeriun e plagosur.



6

Jo! Kur ai pa njeriun e gjakosur, kaloi nga ana tjetër e rrugës.




7

Shpejt, një zhurmë hapash tregoi se një njeri tjetër po afrohej. Ai ishte një Levit - një njeri që ndihmonte priftërinjtë në tempull.




8

Kur u afrua, ai e pa njeriun e plagosur, por vazhdoi rrugën e tij pa e ndihmuar.



Më në fund, një Samaritan kaloi andej. Judenjtë i urrejnë Samaritanët.



Njerëzit që po dëgjonin historinë e Jezusit, nuk e prisnin që një Samaritan të ishte heroi. Por, ai ishte. Samaritanit i erdhi keq, dhe ndaloi ta ndihmojë.



Samaritani u përkul dhe me butësi vendosi ilaç dhe fashoi plagët e të huajit. Pastaj, ai e ndihmoi njeriun e plagosur duke e hypur mbi gomarin e tij.



Në një han buzë rruge, Samaritani u kujdes gjithë natën për atë njeri.




Në mëngjes, ai pagoi të zotin e hanit që të kujdesej për udhëtarin derisa të bëhej mirë.



Historia mbaroi. Jezusi pyeti, "Kush ishte i afërmi i njeriut të plagosur"?




15



Mësuesi i ligjit u përgjigj, "I afërmi i tij ishte Samaritani që tregoi mëshirë".


16

"Shko, dhe bëj po ashtu edhe ti", tha Jezusi. I afërmi ynë është kushdo që ndodhet në nevojë.



17

Ne mund të tregojmë dashuri duke ndihmuar njerëzit në nevojë. Kjo i pëlqen Perëndisë.



18

### Samaritani i Mirë

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Llukes 10

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."  
Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mekatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shume sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë: Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmon. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

**Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!**

